



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>03-02/2320/1</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>04-09-2017</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.09.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-600/17, për z. Murtez Zekolli, Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm të gjendjes së konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt të Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë z. Murtez Zekolli, Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë nga raportuesi i rastit sipas të cilit z. Zekolli Krahas ushtrimit të funksionit si Drejtor i Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës ushtron njëkohësisht edhe funksionet Kryetar i Bordit të Qendrës së Studenteve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Anëtar i Bordit të Stacionit të Autobusëve në Komunën e Therandës, Kryetar i Nëndegës të Partisë Demokratike të Kosovës në Therandë dhe Delegat i Partisë Demokratike të Kosovës nga Theranda në Këshillin Drejtues të PDK – së, me

këtë rast zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare për fillimin e hetimeve të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës është organizuar një takim me zyrtarin e lartë në Agjencinë kundër Korrupsionit.

Gjatë këtij takimi z. Zekolli është deklaruar se tashmë ushtron funksionin si Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë sepse është transferuar në këtë pozitë nga pozita e mëparshme që e kishte në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës. Zyrtari i lartë z. Zekolli nuk e ushtron funksionin e Anëtarit të Bordit të Stacionit të Autobusëve në Therandë, por ushtron funksionin Anëtar i Komisionit të Aksionarëve në Komunën e Therandës. Ndërsa lidhur me ushtrimin e funksionin Kryetar i Bordit të Qendrës së Studentëve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" zyrtari i lartë e ka njoftuar Agjencinë se nuk e ushtron këtë funksion publik sepse me hyrjen në fuqi të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka pushuar së funksionuari ky Këshill.

Ushtrimi i funksionit Kryesues i Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës dhe njëkohësisht Anëtar i Komisionit të Aksionarëve në Komunën e Therandës nuk paraqet konflikt interesi.

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar edhe një shkresë zyrtare (DPKI -03-02-2273/17) me të cilën dëshmohet se me hyrjen në fuqi të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka përfunduar mandati i Këshillit Drejtues dhe rrjedhimisht ky Këshill është shuar.

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar zyrtarisht informata lidhur me atë se çfarë funksionesh ushtron z. Zekolli në Partinë Demokratike të Demokratike të Kosovës.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranua një shkresë zyrtare (DPKI -03-02-2263/17) me të cilën dëshmohet se z. Zekolli ushtron funksionin Kryetar Nën-dege dhe Anëtar i Kryesie i Degës në Therandë, ndërsa pozita e tij nuk ka funksion drejtues në Partinë Demokratike të Kosovës dhe rrjedhimisht nuk ka konflikt interesi sipas Ligjit për shërbimin civil 04/L-149 neni 17 paragrafi 3).

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr/04/L-051 neni 16 paragrafi 1 ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik në të cilin shprehimisht thuhet:

"Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit".

Mirëpo, Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik është i obliguar të veprojë konform dispozitave kufizuese të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil neni 17 (paragrafi 3) cili thotë:

"Nëpunësit civil nuk mund të mbajnë pozita drejtuese në parti politike dhe të jenë aktiv politikisht".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

